



Datë: 19.01.2026

Numër Protokolli: 328/2026

A.nr.1853/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtare, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar në procedurën sipas ankesës A.nr.1853/2025, të datës 29.10.2025, të parashtruar nga ankuesi B.K, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*Transfer*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1853/2025, e datës 29.10.2025 e parashtruar nga ankuesi B.K.

II. Anulohet Vendimi Nr.Ref.420/2025 i datës 30.09.2025, si dhe Vendimi Nr.Ref.373/2025 i datës 02.09.2025, të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmerr të gjitha veprimet juridike me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës sipas Aktit të Emërimit Nr.882/2024 të datës 01.08.2024.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.K, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 29.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokolli 7041/2025, kundër Vendimit Nr.Ref.420/2025 të datës 30.09.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.11.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje: MPJD), ndërsa kjo e fundit më datë 10.11.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 11.12.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:7825/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1853/2025 të datës 29.10.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën e datës 29.10.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.Ref.420/2025 të datës 30.09.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin Nr.Ref.415/2025 të datës 29.09.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin Nr.Ref.130/2025 të datës 26.03.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Kërkesën e datës 01.09.2025; Vendimin Nr.Ref.373/2025 të datës 02.09.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin Nr.Ref.374/2025 të datës 03.09.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; E-mailin e datës 17.10.2025 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Akt Emërimin e datës 13.06.2022; Akt Emërimin e datës 01.08.2024; Raportin e datës 20.01.2023; Raportin e datës 15.01.2024; Raportin e datës 26.12.2024; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.11.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 10.11.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 05.03.2025; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 31.12.2023; Diplomën e ankuesit të datës 05.02.2019; E-mailin e datës 04.11.2025 dërguar nga Zyra e Sekretarit për E.Xh-B me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:7825/2025, i datës 11.12.2025; Kërkesa e datës 26.12.2025; Përgjigje e datës 06.01.2026; Vendimin Nr.427 të datës 16.03.2022 të DMZP-së.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit e është **e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit Nr.882 të datës 01.08.2024 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pozitën “*Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv*”, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm MPJD-së, përmes Vendimit nr.Ref.420/2025 të datës 30.09.2025 e ka transferuar përkohësisht ankuesin në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, dhe atë nga data 01.10.2025 e deri me datë 31.03.2026.

Ankuesi në ankesën e parashtruara kundër aktit të kontestuar, pretendon se organi i punësimit ka vepruar në kundërshtim me ligjin material për shërbimin civil, respektivisht Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, me rastin e nxjerrjes së Vendimit nr.Ref.420/2025 të datës 30.09.2025, ka vepruar pa u konsultuar me Njësinë e Burimeve Njerëzore ngase nuk posedojë nivelin e njohurisë së gjuhës angleze që nevojitet për pozitën përkatëse, sikurse aprovimi i kërkesës së datës 01.09.2025 të znj. Sh.V për ta transferuara të njëjtën në pozitën “*Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv*”, vetëm një (1) muaj para se mua të më kaloj afati i transferimit fillestar është jo i drejtë dhe i pa qëndrueshëm, ngase e njëjta nuk ka rezultatet pozitive në punë siç ajo pretendon në kërkesën e saj, respektivisht e njëjta për shkak të neglizhencës në punë dhe ka pasur pakënaqësi dhe vërejtje nga Drejtori i DSHP-së, sikurse e njëjta nuk ka përvojë pune në administrim të dokumenteve, gjegjësisht e njëjta në pozitën paraprake si udhëheqëse e prokurimit me proces disiplinor-si masë ndëshkuese disiplinore për shkak të shkeljeve dhe vërejtjeve është transferuar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Logjistikës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi përmbajtjen e aktit të kontestuar dhe konstatoi se Vendimi Nr.420/2025 i datës 30.09.2025 është nxjerrë mbi bazën e nenit 63 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe nenit 4 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, dhe erdhe në përfundimin se në rrethanat e rastit konkret bëhet fjalë për transfer të përkohshëm në interes të institucionit.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit mori përbazë se dispozitat e aplikuara nga neni 63 paragrafi 1, në paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “*Nëpunësja/i civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) vjetëve; 2. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale;*”, ndërlidhur me nenin 5 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: “***Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit*** 3. Vendimi për transferim është vendim i arsyetuar i drejtuesit më të lartë administrativ të institucionit. 4. ***Arsyetimi i vendimit të transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin së nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga NjMBNj e institucionit ku nëpunësi është i punësuar***”, dhe mbi këtë bazë kolegji i Këshillit konstatoi se në rrethanat e rastit konkret organi i punësimit me rastin e transferimit të ankuesit

ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ngase sipas përgjigjes së dhënë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së, në bazë të përshkrimit të detyrave të punës për pozitën *‘Udhëheqës i Divizionit për Promovimin dhe Përkrahje të Investimeve’*, në të cilën ankuesi është transferuar, ndër tjerash janë përcaktuar edhe kriteret specifike apo kualifikime të posaçme formale si: *“Njohja e gjuhës angleze në nivelin B2-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze”*, përshkrim ky i cili ka marr pëlqimin nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP/MPB) sipas Vendimit Nr.427 të datës 16.03.2022, kurse në bazë të dosjes personale të ankuesit, dosje kjo e ofruar nga organi i punësimit, nuk mund të dëshmohet, rrjedhimisht ankuesi nuk posedon një kualifikim apo certifikim të tillë, gjegjësisht i njëjta nuk e ka përmbush kriterin e njohjes së gjuhës angleze, kriter ky i cili sipas përshkrimit të detyrave dhe kriterëve të pozitës është i obligueshëm.

Lidhur me pretendimin e organit të paditur se Këshilli për një çështje të ngjashme e kishte refuzuar ankesën e ankuesit me Vendimin A.nr.728/2025, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankuesi në ankesën e tij të datës 29.10.2025, e cila tani është objekt shqyrtimi, e ka pretendim specifik çështjen e kriterit të gjuhës angleze, gjegjësisht mos përmbushjen e këtij kriteri, andaj Kolegji i Këshillit në rrethanat e rastit konkret ka marr për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 134 i LPPA-së ku përcaktohet se: *“134.1. Krahës kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë”*, kurse tek ankesa A.nr.728/2025, pala nuk e kishte pretendim çështjen e përmbushjes së kriterëve specifike që lidhen me njohjen e gjuhës së huaj.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në këtë procedurë të transferit janë evidentuar shkeljet për shkak se është vepruar në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, në mbështetje të dispozitave të nenit 53 dhe nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi që të anuloi Vendimin Nr.Ref.420/2025 e datës 30.09.2025 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pasi që akti në fjalë ishte i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat nga neni 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i LPPA-së ku përcaktohet se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*, duke e obliguar kështu Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së që ta kthej ankuesin në vendin e tij të punës *“Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv”*, sipas Akt të Emërimit të datës 01.08.2024.

Mirëpo, duke pasur parasysh që në pozitën të cilën ankuesi e mban sipas Akt të Emërimit të datës 01.08.2024, është transferuar përkohësisht një zyrtarë tjetër sipas Vendimit Nr.Ref.373/2025 i datës 02.09.2025, të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, atëherë Kolegji i Këshillit me qëllimin për t'i hapur rrugë ligjore kthimit të ligjshmërisë në vend, vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi që të anuloi edhe Vendimin Nr.Ref.373/2025 i datës 02.09.2025, duke ia munduar ankuesit që të kthehet në vendin e tij të punës që e mban sipas aktit të emërimit të cekur si më lartë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nënin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1853/2025, datë 19/01/2026.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, B.K;
- Ministrisë së Punëve të jashtme dhe Diasporës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Komisionit të Ankesave), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.